



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 par. 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/ L-087, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31 e datës 15 qershor 2008, Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Ligjit nr. 05/l -009 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar më Ligjin nr. 04/l-111 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

Neni 1

Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi" (në vazhdim të tekstit Komisioni) në përbërje si vijon :

1. Sead Aliu, anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës,
2. Fadil Sopa, anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe ,
3. Herolind Kozhani, anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës.

Neni 2

Komisioni do të veprojë në emër të Komunës dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Komisioni i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësive, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.2 të Ligjit për Ndërmarrjet publike. Komisioni do t'i sigurojë të dhëna

kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes publike lokale në interes të Komunës.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionarëve 15-463/ 06-21274 i datës 26.04.2022 .

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-15247

Lipjan, më 31.03.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

